



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 113, Datë 26.04.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË  
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI PËR  
VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të Ligjit nr. 7/2017 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, *“Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”*; dhe nenit 15, të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 23.04.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, *“Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020”*,

**Konstatohet se:**

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës *“Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020”*.
- Paraprakisht kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 1249, datë 07.12.2020, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) informacion në lidhje me Autorizimet paraprake apo Miratimet përfundimtare që janë dhënë nga nga kjo e fundit, gjatë vitit 2020 në lidhje me ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, si dhe për gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale.

- MIE me anë të shkresës nr. 1249/1 prot., datë 29.12.2020 është shprehur se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të Kapaciteteve të reja prodhuese të Energjisë Elektrike, që nuk janë objekt Koncesioni”, i ndryshuar, nuk ka lëshuar asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Mbylljen e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli për vitin 2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK) si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a) për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**